



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:160167

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05537114

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.140/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, (në Objektin e Gjykatës në Mitrovicë-Veri), kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët, Xhemajl Jusufi dhe Fatos Sejdiqaj, me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri dhe procesmbajtësen Edita Kelmendi, në çështjen penale ndaj të pandehurit V.Rr, për shkak të veprave penale; vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 e 31 të të Kodit Penal të Kosovës (më tej KPRK-së) dhe veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr.142/2016 dt.19.10.2016. Në këtë çështje penale është mbajtur shqyrtimi gjyqësor, seanca e shqyrtimit gjyqësor ka qenë e hapur për publikun, dhe është mbajtur në prezencën e palëve; prokurorit të shtetit në PTH-Mitrovicë, Sahit Tmava, të pandehurit V.Rr, mbrojtësit av.Shefqet Ibrahimimi dhe të dëmtuarës N.Rr, si dhe në mungesë të të dëmtuarit V.S. Shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar më 29.03.2024 të njëjtën ditë është shpall publikisht aktgjykimi, ndërsa më 03.04.2024 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

I pandehuri;

V.Rr nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur më dt..... në fshatin A.....-S....., tani me vendbanim në rruga “.....”nr....., me numër personal, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i punësuar në Z....., i gjendjes së mesme ekonomike, i njëjti;

I.

Në mbështetje të nenit 362 par.1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Më datë 27.08.2016 rreth orës 18;40 minuta, në bashkëkryerje me të pandehurin V.Rr në parkingun e restorantit “.....” në fshatin K....., komuna e M....., kanë tentuar që ta privojnë nga jeta të dëmtuarin V.S, në atë mënyrë që i dëmtuari ka qenë te vetura e tij kur të pandehurit i janë afruara duke i thënë “se me kënd del ti nëpër restourante”, pastaj i pandehuri V.Rr e ka sulmuar të dëmtuarin me boks, ndërsa i dëmtuari ishte mbrojtur me duar e ku, pastaj i pandehuri V.Rr e kishte godit të dëmtuarin me thikë një herë në bark dhe një herë në shpinë në krahrorin e djathtë dhe i dëmtuari pëson plagë trupore, kurse të pandehurit me automjetin e markës “.....” me targa z....., pronë e të pandehurit V.Rr largohen nga vendi i ngjarjes.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale; Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 e 31 të Kodit Penal të Kosovës.

II.

Në mbështetje të nenet 362 par.1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Më datën 27.08.2016, kohën dhe vendin e njëjtë si në pikën I të dispozitivit me dashje ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarës N.Rr ashtu që, e ka sulmuar të njëjtën duke e goditur me grusht në fytyrë.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale: Sulmi nga neni 187 par.1 të Kodit Penal të Kosovës, në bashkim real me veprën penale si në pikën I të dispozitivit.
- Të dëmtuarit V.S dhe N.Rr, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.
- I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e procedurës mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

- Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën, PP.I.nr.142/2016, të datës 18.10.2016, kundër të pandehurve; V.Rr dhe V.Rr, për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 e 31 të Kodit Penal të Kosovës, ndërsa i pandehuri V.Rr edhe për veprën penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.140/2016 të datës 04.11.2016, ndaj të pandehurit V.Rr është veçuar procedura dhe çështja penale kundër tij, ka përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm. Ndërsa për të pandehurin V.Rr ka vazhduar procedura penale sipas numrit të vjetër të lëndës P.nr.140/2016.

- Kompetenca;

Sipas nenit 1, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Laposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra penale e vrasjes në tentativë, ka ndodhur në fshatin K....., komuna e Mitrovicës dhe rrjedhimisht, bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29, paragrafi 1 i KPP-së. Sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo natyrë e veprave penale për të cilën akuzohet i pandehuri, sipas nenit 22 par.1, nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafi 1.2 pika 1.2.54 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) hynë në kompetencë të Departamentit për krime të rënda.

- Rrjedha e procedurës:

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor më datë 29 mars 2024. Seanca e shqyrtimit gjyqësor ka qenë publike, rrjedha e saj është regjistruar në procesverbal dhe është mbajtur në prezencën e palëve; prokurorit të shtetit Sahit Tmava, të pandehurit V.Rr, mbrojtësit të tij av.Shefqet Ibrahimit dhe të dëmtuarës N.Rr si dhe në mungesë të të dëmtuarit V.S.

Gjatë paraqitjes së fjalës përfundimtare, prokurori i shtetit është tërheq nga akuza dhe ndjekja penale ndaj të pandehurit V.Rr, për veprën penale; vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 e 31 të KPRK-së. Me arsyetimin se në veprimet e të pandehurit nuk janë përmbushur elementet e veprës penale në fjalë. Sipas prokurorit, në veprimet e të pandehurit në këtë rast përmbushen elementet e veprës penale të Sulmit nga neni 187 par.1 të Kodit Penal të Kosovës, mirëpo në raport me këtë vepër penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

- Gjetjet e gjykatës:

Gjykata, pasi që prokurori i shtetit në PTH- Mitrovicë, është tërhequr nga akuza dhe ndjekja penale ndaj të pandehurit V.Rr për veprën penale, vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 e 31 të KPRK-së, vlerëson se prokuroria ka të drejtë ligjore në çdo kohë të tërhiqet nga ndjekja penale, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Bazuar në këto arsye kjo Gjykatë vlerëson se në mungesë të aktakuzës nuk mund të vazhdoj shqyrtimin gjyqësor dhe trajtimi i çështjes në raport me veprën penale për të cilën është tërheq prokuroria. Mbi këtë bazë, gjykata konstaton se në tërësi janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës dhe për nxjerrjen e aktgjykimit refuzues, sipas nenit 362 par.1 nën par 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

- Sa i përket pikës II të aktakuzës;

Në rastin konkret i pandehuri V.Rr është akuzuar edhe për veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të Kodit Penal të Kosovës, për të cilën parashihet sipas Kodit Penal të Republike se Kosovës përshihet: *“dënim me gjobë ase me burgim deri në tre (3) vjet”*

Gjykata rikujton se në bazë të nenit 106 par.1 nën par 1.5 të KPRK-së, përcaktohet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tri (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit e deri në tre (3) vjet burgim. Ndërkaq, sipas nenit 107 par.1 të KPRK-së, përcaktohet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedhë nga dita kur është kryer vepra penale, ndërsa paragrafi 8 i këtij neni përcakton se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit. Gjykata nga të gjitha faktet dhe provat e lartë cekura konstaton se nga data 27.08.2016 kur dyshohet se është kryer vepra penale; Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së e deri me datë 29.03.2024 kanë

kaluar më tepër se gjashtë (6) vite, që sipas nenit 91 par.6 të KPRK-së, në këtë rast penal ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Parashkrimi absolut në këtë rast ka arritur më datë 28.08.2022, ngase ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të përcaktuar me dispozitën e nenit 106 par.1 nën par 1.5 të KPRK-së.

Gjykata duke vlerësuar këtë fakt konstaton se parashkrim i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, gjykata obligohet që sipas ligjit të refuzoj akuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që, kjo Gjykatë pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit V.Rr, sa i përket veprës penale. sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, ka arrit parashkrimi absolut i ndjekjes penale dhe nga këto arsye kjo gjykatë e ka refuzuar aktakuzën duke u bazuar në nenit 362 par.1 nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale.

- Lidhur me shpenzimet e procedurës penale:

Gjykata e ka liruar të pandehurin V.Rr, nga shpenzimet e procedurës penale, pasi që gjykata ka vendos ta refuzoj akuzën ndaj tij, kjo në bazë të dispozitës së nenit 453 par.1 të KPP-së.

- Lidhur me kërkesën pasurore juridike:

Gjykata e ka udhëzuar palën e dëmtuar në kontest civil, në kuptim të nenit 462 par.3 të KPP-së.

Nga ajo që u tha me lart u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.140/2016 dt:03.04.2024

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, pas pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.